



## PROCES VERBAL i mbledhjes së Asamblesë

Sot, më 28/06/2022, në orën 10:00, në Tiranë, Shqipëri, në zyrën e regjistruar të ndodhur në Rruga "Ibrahim Rugova", Nd. 70, H. 5, Ap. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri, është mbledhur në thirrjen e parë Asambleja e Aksionerëve të shoqërisë "LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE" Sh.a., e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive me vendimin nr. 28113, datë 30.7.2002 të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi (NUIS) K71906007R, me kapital themeltar në vlerën 2.165.800.000 Lekë, i ndarë në 216.580 aksione me vlerën 10.000 lekë secila.

Mbledhja është thirrur me anë të njoftimit të datës 7 Qershor 2022, të nënshkruar nga Administratori Stefano Borghesi, duke iu përmbajtur termave dhe procedurës së parashikuar për njoftimin e aksionerëve, siç parashikohet nga Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ("**Ligji 9901**") dhe në bazë të nenit 10 të statutit të Shoqërisë.

Në mbledhje marrin pjesë aksioneri i vetëm i Shoqërisë:

- La Petrolifera Italo Rumena S.p.A. me seli në Milano, Itali, që zotëron 100% të aksioneve të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar në mbledhje nga Vera Batalli, e autorizuar ligjërisht me anë të Prokurës datë 7 qershor 2022, e autentifikuar nga Dr. Tommaso Gherardi, noter në Bolonjë, lëshuar nga Dr. Guifo Ottolenghi, lindur në Bolonjë më datë 25 mars 1966, me banim në Bolonjë, në cilësinë e Administratorit të Deleguar;

Meqënëse ky numër përfaqëson më shumë se 95% të numrit të përgjithshëm të aksioneve të shoqërisë, Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme, në bazë të neneve 144 dhe 145 të Ligjit 9901 dhe nenit 13 të Statutit të Shoqërisë.

Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme është si vijon:

1. miratimi i Bilancit të Shoqërisë për vitin financiar janar-dhjetor 2021 ;



2. miratimi i raportit të Bilancit përgatitur nga eksperti kontabël i Shoqërisë dhe të Raportit të Administratorëve;
3. destinimin e fitimit të shoqërisë për vitin financiar janar-dhjetor 2021;
4. emërimi i ekspertit kontabël të Shoqërisë për vitin financiar janar-dhjetor 2022
5. zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë nëpërmjet konverimit të Huasë së Konvertueshme në shumën 260.000 Euro dhe emërimi i ekspertit kontabël;

Mbledhja drejtohet nga Administratori i Shoqërisë, kap. Anastas Goga.

Për pikën e parë të rendit të ditës e merr fjalën kap. Goga, i cili parashtron si më poshtë:

Më datë 31 mars 2022 u dorëzua në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë, Shqipëri, Bilanci i Shoqërisë, për vitin financiar janar-dhjetor 2021, i cili ishte hartuar në përputhje me rregullat dhe legjislacionin shqiptar të kontabilitetit. Bilanci rezulton në një fitim prej 159.671.026 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e njëzet e gjashtë ) Lekë.

Ftohet pra Asambleja e Zakonshme që të aprovojë bilancin e përmendur më sipër.

Kalohet në votim. Aksioneri i vetëm i Shoqërisë voton në favor; meqënëse kjo votë përbën 100% të numrit total të votave, vendimi i marrë konsiderohet vlefshëm.

Për pikën e dytë të rendit të ditës, rimerr fjalën Presidenti i Asamblesë, i cili i paraqet Asamblesë Raportin e Bilancit të përgatitur nga eksperti kontabël i shoqërisë, Ernst & Young EKA Sh.p.k., si dhe Raportin e ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë, dokumentet e të cilit aksionarët i kanë lexuar tashmë pa ndonjë vërejtje.

Ftohet Asambleja që të aprovojë Raportin e Bilancit për vitin 2021.

Kalohet në votim. Aksioneri i vetëm i Shoqërisë voton në favor; meqënëse kjo votë përbën 100% të numrit total të votave, vendimi i marrë konsiderohet i vlefshëm.

Për pikën e tretë të rendit të ditës e rimerr fjalën Presidenti i Asamblesë, i cili, marrë parasysh situatën financiare të Shoqërisë në lidhje me investime të mundshme, vlerëson të përshtatshme që mos të procedohet me shpërndarjen e dividendëve dhe propozon që fitimi në Bilancin 2021, në shumën 159.671.026 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e njëzet e gjashtë ) Lekë të përdoret:

- deri në 5% të barabartë me 7.983.551 Lekë për Rezervën Ligjore



- për pjesën e mbetur, si Fitim Rezervë i Pashpërndarë.

Pas këtij propozimi kalohet në votim. Aksioneri i vetëm i Shoqërisë voton në favor; meqënëse kjo votë përbën 100% të numrit total të votave, vendimi i marrë konsiderohet i vlefshëm.

Për pikën e katërt të rendit të ditës, Presidenti informon Asamblenë se në bazë të Ligjit 9901 është e nevojshme që Bilanci i vitit 31 dhjetor 2022 i shoqërisë të shoqërohet nga Raporti i Ekspertit Kontabël; prandaj është e nevojshme që të emërojë këtë të fundit. Ftohet Asambleja që të rinovojë emërimin e Shoqërisë Ernst & Young EKA Sh.P.K. – Dega në Shqipëri, regjistruar ne Regjistrin e Ekspertëve Kontabël (IEKA) me vendimin nr. 112 datë 20.12.2006, deri në miratimin e Bilancit 31 dhjetor 2022, deri më 30 Qershor 2023.

Pas këtij propozimi u kalua kalohet në votim. Aksioneri i vetëm i Shoqërisë votoi në favor; duke qenë se kjo votë përbën 100% të numrit total të votave, vendimi i marrë konsiderohet i vlefshëm.

Për pikën e pestë të rendit të ditës e rimerr fjalën Presidenti Goga i cili i vë në dukje Asamblesë se është në fuqi një hua e kthyeshme prej 260.000 Euro e lidhur midis Shoqërisë dhe Z. Gudio Ottolenghi, e miratuar nga Asambleja e Shoqërisë me 20.12.2007 dhe e nënshkruar mes palëve në datën 25/06/2008, me skadencë fillestare në datën 30/06/2021, dhe e rinovuar me Adendumin e datës 23/12/2020 deri më 30/06/2022, dhe që mund të shtyhet sërish sipas kërkesës së dhënësit të huasë deri në datë 30/06/2026. Kjo hua mund të ripaguhet në skadencën e sja nëpërmjet parave ose nëpërmjet konvertimit në një numar maksimal prej 3.128 aksionesh të Shoqërisë, për një vlerë nominale deri në një maksimum prej 31.280.000 Lekë. Presidenti informon se Z. Ottolenghi, me anë të kërkeses së datës 07.06.2022, ka kërkuar kthimin e huase në aksione, në datën e skadencës së kontratës më 30.06.2022, për këtë qëllim është i nevojshëm edhe emërimi i eksperit kontabël për përgatitje e raportit përkatës për zmadhimin e kapitalit.

Në këtë kuadër Presidneti Goga propozon vendim-marrjen si më poshtë:

- zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë, me efekt në datën 30 Qershor 2022, deri në shumën 2.197.080.000 lekë, nëpërmjet emetimit të 3.128 aksioneve të reja, në emër të Z. Guido Ottolenghi, me një vlerë nominale prej 10.000 lekë secila, në një vlerë totale prej 31.280.000 lekë, nëpërmjet konvertimit të huasë së konvertueshme në vlerën 260.000 Euro; diferenca të mundshme që mund të rezultojnë nga kursi i këmbimit i sotëm i përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, do të kontabilizohen në Rezervën Ligjore ekzistuese.



- emërimin e Znj. Mirela Meta, me numër license profesionale 385 të datës 25.03.2019, për të përgatitur raportin përkatës për rritjen e kapitalit;
- modifikimin e nenit 5 të Statutit të Shoqërisë si në vijim:

*Neni 5) - Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.197.080.000 (dymiliard e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e tetëdhjetë) lekë, i ndarë në 219.708 (dyqind e nëntëmbëdhjetë shtatëqind e tetë) aksione të zakonshme, me një vlerë nominale prej 10.000 (dhjetmijë) Lekë secila.*

*Aksioneri La Petrolifera Italo Rumena S.p.A zotëron 216.580 aksione të zakonshme në kapitalin themeltar të shoqërisë, të barabarta me 98.58% të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë nominale prej 10.000 (dhjetëmijë) Leke secila, në një vlerë totale prej 2.165.800 Lekë.*

*Aksioneri Guido Ottolenghi zotëron 3.128 aksione të zakonshme në kapitalin themeltar të Shoqërisë, të barabarta me 1.42% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, me vlerë nominale prej 10.000 (dhjetëmijë) Lekë secila, në një vlerë totale prej 31.280.000 Lekë.*

Pas këtij propozimi u kalua kalohet në votim. Aksioneri i vetëm i Shoqërisë votoi në favor; duke qenë se kjo votë përbën 100% të numrit total të votave, vendimi i marrë konsiderohet i vlefshëm.

Si rrjedhojë, me efekt nga 30 qershor 2022 dhe në varësi edhe të paraqitjes së raportit të zmadhimit të kapitalit, konsiderohet i kryer zmadhimi i kapitalit aksioner të Shoqërisë deri në 2,197,080,000 Lekë (e barabartë me një numër total prej 219,708 aksionesh në vlerën 10,000 Lekë secila), nëpërmjet emetimit të 3,128 aksioneve nominale, me vlerë nominale 10,000 (dhjetë mijë) Lekë secili, për një vlerë totale prej 31,280,000 Lekë, ekuivalente me 260,000,00 Euro.

Për sa më sipër, kapitali i Shoqërisë rezulton i ndarë si më poshtë:

- n. 216,580 aksione të zakonshme, me vlerë nominale 10,000 lekë secila, për një vlerë totale prej 2,165,800,000 lekë ose 98,58% e kapitalit aksioner është në pronësi të aksionerit La Petrolifera Italo Rumena S.p.A.
- n. 3,128 aksione të zakonshme, me vlerë nominale 10,000 lekë secila, me një vlerë totale prej 31,280,000 lekë ose 1,42% e kapitalit aksioner është në pronësi të aksionerit Guido Ottolenghi, shtetas italian, lindur në Bolonjë më 25.03.1966.

Meqënëse asnjë nga të pranishmit nuk e kërkon fjalën dhe meqënëse nuk ka asgjë tjetër për t'u vendosur, mbledhja konsiderohet e mbyllur, pasi lexohet paraprakisht, miratohet dhe nënshkruhet ky proces verbal.

**La Petrolifera Italo Rumena S.p.A**

**Anastas Goga**

**Vera Batalli**



*Anastas Goga*  
22

*Vera Batalli*

G/A4

**LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE SH.A.**

Rruga Ibrahim Rugova, Nd. 70, H.5, Ap. 5

**1019 Tirana, Albania**

Bologna, li 07/06/2022

OGGETTO: Delega

il sottoscritto dr. **Guido Ottolenghi** nato a Bologna il 25 marzo 1966, domiciliato per la carica in Bologna, Viale Aldini n. 190, Codice Fiscale TTL GDU 66C25 A944P, nella sua qualità di Amministratore Delegato munito dei necessari poteri per quanto infra per conto ed in legale rappresentanza della Società La Petrolifera Italo Rumena S.p.A. con sede legale in Milano, Via del Bollo n. 4 e sede amministrativa in Bologna, Viale Aldini n. 190, Capitale Sociale Euro 486.000 interamente versato, iscritta al n. 00745880153 del Registro delle Imprese di Milano, Codice Fiscale e Partita IVA 00745880153, titolare di n. 216.580 azioni pari al 100% del Capitale Sociale della Vostra Società con la presente

delega

- **BATALLI Vera**, nata il 22.12.1979, con documento di identità n. 027889870, residente in Rruga Frosina Plaku, Pall. 13, Ap. 4, Tirana, Albania;
- **SHIMA Marsilda**, nata il 29.01.1993, con documento di identità n. 028692942, residente in Rruga Jusuf Alibali, Lagjia n. 1, Tirana, Albania;

In via disgiunta tra di loro a partecipare all'Assemblea dei Soci de La Petrolifera Italo Albanese Sh.A. che si terrà presso la sede sociale il giorno 28 giugno 2022 alle ore 10.00 in prima convocazione e, occorrendo, in seconda convocazione il giorno 29 giugno 2022, stessi ora e luogo, per deliberare sul seguente

Ordine del Giorno:

1. approvazione del Bilancio della Società per l'esercizio sociale gennaio-dicembre 2021;
2. approvazione della relazione al Bilancio preparata dal revisore contabile della Società e della relazione degli Amministratori;
3. Destinazione dell'utile dell'esercizio sociale gennaio-dicembre 2021;
4. nomina del revisore contabile della Società per l'esercizio sociale gennaio-dicembre 2022;
5. Aumento di capitale sociale mediante conversione del Convertible Loan di Euro 260.000.

Il sottoscritto dichiara di ritenere fin d'ora per rato e valido l'operato dei suddetti delegati.

**La Petrolifera Italo Rumena S.p.a.**  
Amministratore Delegato e Direttore Generale  
Guido Ottolenghi



**VERA DI FIRMA**



Certifico io sottoscritto Dr. TOMMASO GHERARDI, Notaio iscritto nel Ruolo del Distretto Notarile di Bologna, con residenza in questa città vera ed autentica la firma del Signor:

- **OTTOLENGHI Guido**, nato a Bologna il 25 marzo 1966, domiciliato per la carica in Bologna, Viale Aldini n. 190, nella sua qualità di Amministratore Delegato e Direttore Generale della società "LA PETROLIFERA ITALO RUMENA S.P.A. con sede legale in Milano, via del Bollo n. 4, della cui identità personale, qualifica e poteri io Notaio sono certo.

Io Notaio dichiaro di conoscere la lingua Inglese.

In Bologna, li 7 (sette) giugno 2022 (duemilaventidue).

DOTTOR TOMMASO GHERARDI NOTAIO



**TRUE SIGNATURE**



I Dr. Tommaso Gherardi of the city of Bologna, Italy, Notary Public duly admitted and sworn practising in the said city, do hereby certify and attest that the signature set and subscribed is truly that of

- **OTTOLENGHI Guido**, born in Bologna (BO) on March 25th, 1966, domiciled in Bologna, Viale Aldini n. 190, in his capacity as Chief Executive Officer and General Manager of the company " LA PETROLIFERA ITALO RUMENA S.P.A " having its head office at Milano, via del Bollo n. 4, of whose identity I Notary am certain.

I, Notary, declare that I know English Language.

In Bologna, there 7 June 2022

DOTTOR TOMMASO GHERARDI NOTAIO





# PROCURA DELLA REPUBBLICA DI BOLOGNA

## APOSTILLE

Convention de La Haye du 5 octobre 1961


1. Stato: ITALIA  
Il presente atto pubblico
2. è stato sottoscritto da TOMMASO GHERARDI
3. agente in qualità di NOTAIO IN BOLOGNA
4. è segnato dal sigillo /bollo PROPRIO DEL NOTAIO

## ATTESTATO

5. a Bologna
6. il \_\_\_\_\_
7. da PROCURA DELLA REPUBBLICA DI BOLOGNA
8. sotto il numero 2179 /2022 Reg. Apostille
9. sigillo/bollo

10. Firma

IL SOSTITUTO PROCURATORE DELLA REPUBBLICA



*Nicola Scalabrini*  
**Il Procuratore della Repubblica**  
**Dott. Nicola Scalabrini sost.**

- 8 GIU. 2022





## LA PETROLIFERA ITALO RUMENA

LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE SH.A

Rr. Ibrahim Rugova, Nd.70, H.5, Ap.5  
1019 Tirana , Albania

Bologna, më 7 Qershor 2022

Objekti: PROKURË

Unë, i nënshkruari Dr. **Guido Ottolenghi**, lindur në Bologna më 25 mars 1966 dhe banues për shkak të detyrës në Bologna, Viale Aldini n. 190, me Kod Fiskal TTL GDU 66C25 A944P, në cilësinë e tij si Administrator i Deleguar i pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme, dhe në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të "**La Petrolifera Italo Rumena S.p.A.**" me seli në Milano, Via del Bollo n. 4, dhe seli administrative në Bologna, Viale Aldini nr. 190, kapitali aksionar prej 486,000.00 € (486.000 euro), i shlyer plotësisht, me kod fiskal, nr. TVSH dhe numër regjistrimi në Regjistrin e Shoqërive të Dhomës së Tregtisë së Milanos 00745880153, mbajtës i një numri prej 216.580 aksionesh të barabarta me 100% të kapitalit të shoqërisë suaj me këtë dokument

Autorizon

- Vera BATALLI, lindur më 22 dhjetor 1979, identifikuar me kartën e identitetit nr. 027889870, banuese në Rruga Frosina Plaku, Pall. 13, Ap.4, Tiranë, Shqipëri;
- Marsilda SHIMA, lindur më 29.01.1993, identifikuar me kartën e identitetit n. 028692942, banuese në Rr. Jusuf Alibali, Lagjia Nr.1, Tiranë, Shqipëri;

Në mënyrë të ndarë nga njëra-tjetra për të marrë pjesë në Asamblenë e Shoqërisë La Petrolifera Italo Albanese Sh.A, që do të mbahet në selinë e shoqërisë, më 28 Qershor 2022 në orën 10.00 në thirrjen e parë dhe, nëse është e nevojshme, në thirrjen e dytë më 29 Qershor 2020, në të njëjtën kohë dhe vend, për të diskutuar në rendin e ditës:

1. Aprovim i Bilancit të Shoqërisë për vitin financiar janar – dhjetor 2021;
2. Aprovim i relacionit të Bilancit të përgatitur nga eksperti kontabël i Shoqërisë dhe i relacionit të Administratorëve;
3. Destinimi i fitimit për vitin financiar janar-dhjetor 2021;
4. Emërimi i ekspertit kontabël të shoqërisë për vitin financiar janar-dhjetor 2022.



5. Rritja e kapitalit të regjistruar nëpërmjet konvertimit të Huasë së Konvertueshme prej 260.000 euro.

I nënshkruari deklaron se e konsideron të vlefshme dhe të duhur detyrën e përfaqësueve të sipërpërmendur që nga ky moment.

**La Petrolifera Italo Rumena S.p.a**

Administrator dhe Drejtor i Përgjithshëm  
Giudo Ottolenghi

## NËSHKRIM I VËRTETË

Unë, i nënshkruari, Dr. TOMMASO GHERARDI, Noter i regjistruar ne Regjistrin e Distriktit Noterial të Bologna-s, Itali, me adresë në qytetin e përmendur, certifikoj si të vërtetë dhe autentik, nënshkrimin e Zotit:

-OTTOLENGHI Guido, lindur në Bologna më 25 mars 1966 dhe banues për shkak të detyrës në Bologna, Viale Aldini n. 190, në cilësinë e tij si Administrator i Deleguar dhe Drejtor i Përgjithëshëm i shoqërisë "LA PETROLIFERA ITALO RUMENA S.P.A." me seli në Milano, Via del Bollo n. 4, për identitetin, cilësinë dhe kompetencat e të cilit UNE noteri jam i sigurt.

Unë, Noteri, deklaroj se njoh gjuhën angleze.

Në Bologna, më 7 (shtatë) Qershor 2022 (dymijë e njëzet e dy)

DR. TOMMASO GHERARDI NOTER

(nënshkrimi)

### VULA APOSTILE

(Konventa e Hagës 5 tetor 1961)

1. Shteti :ITALI

Ky dokument publik

2. është nënshkruar nga TOMMASO GHERARDI

3. në funksionin e NOTERIT NË BOLOGNA

4. Dhe mban vulën e vetë Noterit

Certifikuar

5. Në Bologna

6. Më 8 Qershor 2022

Nga Prokura e Republikës së Bologna-s

8. Me nr. 2179/2022 Regj. Apostil

9. Vula

10. Nënshkrimi

PROKURORI I REPUBLIKËS

Dr. Nicola Scakabrini

(nënshkrimi)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE TIRANË**  
**NOTER EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI)**



V202205301014873298

**DATE 30/06/2022**  
**NR REP 2575**

**VËRTETIM PËRKTHIMI**

Sot, më datë 30/06/2022, para meje Notere EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën RR.SAMI FRASHERI, PALLATI BLU PERBALLE GJIMNAZIT PETRO NINI LUARASI ,KATI 2, u paraqit personalisht:

**PËRKTHYES:**

Thodhori Kamberi, atësia Kristostom, amësia Amalina, shtetas Shqiptar, lindur në Athinë, Greqi (GRC) dhe banues në TIRANË, me adresë Pjetër Budi; Nd. 19; H. 19; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1010; Tiranë, lindur më 18/06/1991, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035071118 dhe nr. personal J10618107T .

Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur “Shkresën e dakordësisë, të datës 7 Qershor 2022, ndërmjet shoqërisë La Petrolifera Italo-Albanese Sh.a., dhe Z. Guido Ottolenghi, në lidhje me Marrëveshjen e Huasë datë 25 Qershor 2008”, nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”;” në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

**EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI)**

